



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

N. Prot. 255

Tiranë më 28/8/2025

Rregullore për transferim të studimeve në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" Viti akademik 2025 -2026

Informacion i përgjithshëm

Procedurat e transferimit të studimeve në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" (në vijim UKZKM) miratohen në përputhje me Urdhrin nr.12, të datës 30.06.2023, Urdhrin e përbashkët nr. 157 dt. 03.06.2025 QSHA-RASH dhe Dekretit të Rektorit nr. 231 dt. 13.06.2024 dhe nr. 231/1 dt. 13.09.2024 të publikuar në faqen zyrtare: www.unizkm.al.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 436, të datës 03.06.2020, e ndryshuar me VKM nr.46 të datës 27/01/2021 të Republikës së Shqipërisë për përcaktimin e kriterit të notës mesatare, në rastet e transferimit të studimeve në UKZKM, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM përkatëse të vitit akademik që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016-2017.

Kandidatët e huaj që nuk e kanë përfunduar arsimin e mesëm në Itali ose në një shkollë të mesme ku gjuha zyrtare e mësimi nuk është gjuha italiane, duhet të kenë Certifikatën e mbrojtjes së gjuhës italiane të paktën në nivelin B1, siç parashikohet në Udhëzimin Nr. 52 datë 03/12/2015, ose të kryejnë testimin mbi njohjen e Gjuhës Italiane të organizuar nga UKZKM në momentin e regjistrimit.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen njëkohësisht në disa programe studimi në të njëjtin vit akademik, në universitete publike dhe/ose private, shqiptare.

Kreu I- Procedurat e transferimit për kandidatët shtetas shqiptarë

1. Si të aplikoni për transferimin e studimeve

Sipas Urdhrit të përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 të QSHA-RASH dhe Udhëzimit nr. 12 dt. 30.06.2023, kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për transferim të studimeve në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të UKZKM nga data 01 shtator deri në datën 12 shtator 2025 sipas hapave të mëposhtëm:

- të kryejnë regjistrimin online në Portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/>
 - të përzgjedhin zërin: "Trasferimento degli studi"
 - të plotësojnë procedurën duke ngarkuar online kopje elektronike në format PDF (të skanuara në format pdf/A) dokumentacionin e mëposhtëm për transferimin e studimeve:
- a) Kërkesën për transferim drejtuar IAL (shkarkohet në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>)
 - b) Planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse. Studenti që transferon studimet nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, dorëzon të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

njësuar me origjinalin planin e plotë të programit të studimit përfshirë syllabuset përkatëse si dhe listën e notave me kreditet e fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer;

- c) vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;
- d) kopje të njësuar me origjinalin të diplomës së Maturës Shtetërore/dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011;
- e) kopje të dokumentit të identifikimit;
- f) kandidati duhet të dërgojë gjithashtu në kërkesën për transferim një kopje të akreditimit institucional të Universitetit të origjinës dhe një kopje të akreditimit të fundit të programit të studimit që është objekt i kërkesës për transferim, ose dokumentet dhe/ose referencat e marra nga burime të tjera publike (agjenci akreditimi, ministri dhe institucione varësie, etj).

Shënim: Dokumentacioni duhet të përkthehet në gjuhën italiane ose në gjuhën angleze para se të ngarkohet në portal.

Pas ngarkimit të dokumentacionit të mësipërm, do të kryhen verifikimet përkatëse dhe llogaritja e notës mestare për çdo kandidat. Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>.

2. Procedurat e transferimit në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit të të njëjtit cikël, për programet e studimit në Mjekësi, Odontoiatri dhe Proteza Dentare:

Kandidatët që kanë ngarkuar dokumentacionin e plotë/të rregullt në portalin e pranimeve: <http://admissions.unizkm.al/> dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare sipas V.K.M nr. 436, dt. 03/06/2020, e ndryshuar me VKM nr.46 të datës 27/01/2021 të Republikës së Shqipërisë, do të vlerësohen paraprakisht për studimet universitare të kryera më parë. Nëse gjatë këtij procesi verifikimi, kreditet e fituara në programin nga vjen rezultojnë të mjaftueshme për të transferuar të paktën 30 kredite në programin ku aplikon për transferim, kandidatët do të konsiderohen "Kandidatë që kualifikohen për procesin e transferimit" dhe **duhet të kryejnë testimin e pranimit** pranë UKZKM për kuotat e parashikuara për transferim në programet e studimit në datat e mëposhtme:

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në <i>Mjekësi dhe Kirurgji</i>	24/09/2025	10:00
Programi i integruar i studimit "Master i Shkencave" në <i>Odontoiatri dhe Proteza Dentare</i>	24/09/2025	12:00

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara në testimet e mëposhtme dhe nga vlerësimi i mesatares së përgjithshme së shkollës së mesme:

1. Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim mbi njohjen e gjuhës italiane	20 pikë



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Totali	80 pikë

Transferimi i studimeve në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë të UKZKM u lejonet studentëve që vijnë nga programe studimi të të njëjtit cikël dhe së njëjtës fushë studimi të universiteteve publike shqiptare dhe universiteteve publike dhe private të huaja, të licensuara dhe të akredituara në vendet e origjinës në momentin e aplikimit për transferim.

Pranohen pa kryer testimin e pranimit dhe kanë përparësi në listën e renditjes së aplikantëve duke u renditur sipas kriterit të mesatares së ponderuar të provimeve të dhëna në Universitetin e origjinës, kandidatët që vijnë nga programe të njëjta studimi nga Universitete të Bashkimit Evropian, të njohura nga Universiteti ynë, sipas marrëveshjeve me Universitetin partner italian për transferim direkt të studimeve.

3. Procedurat e transferimit në programet e studimit në Arkitekturë, Ekonomi Ndërmarrjeje dhe Farmaci:

Dokumentacioni i kandidatëve që paraqesin kërkesë transferimi për këto programe studimi do i përcillet Komisionit Didaktik *ad hoc* për vlerësimin e studimeve universitare të kryera më parë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara nga mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme dhe studimeve universitare të kryera më parë:

1.	Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	50 pikë
2.	Studimet universitare të kryera më parë (Kredite të njohura)	50 pikë
	Totali	100 pikë

Shënim: Kandidatët që nuk kanë të paktën 30 kredite të njohura në programin ku aplikojnë për transferim, aplikojnë për regjistrim në vit të parë. Komisioni Didaktik *ad hoc* përcakton lëndën dhe masën e njohjes së tyre,

4. Tarifat

Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve duhet të paguajnë tarifën e mëposhtme **brenda datës 12 shtator 2025, ora 16:30:**

- 50 Euro nga Universitete të tjera drejt Universitetit Katolik ZKM;
- 20 Euro nga një program tjetër studimi brenda Universitetit Katolik ZKM;

Kandidatët që do të kryejnë edhe testim pranimi, duhet të kryejnë edhe pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në testim prej 2.000 Lekë **brenda datës 15 shtator 2024, ora 16:30.**

Pagesa e tarifave të mësipërme mund të kryhet:



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- pranë filialeve të Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë¹ me këto të dhëna:

Përfituesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)

IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë.

- me kartë krediti online në portalin e universitetit: <https://admissions.unizkm.al/#/auth/signin>

- pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30.

5. Listat e renditjes

Listat e renditjes së aplikantëve do të publikohen në faqen zyrtare të UKZKM: <https://www.unizkm.al/> brenda datës **26 shtator 2025** Kandidatët mund të përjashtohen nga lista e renditjes nëse gjenden parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për aplikim.

6. Procesi i regjistrimit

Sipas Urdhrit të përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 të QSHA-RASH dhe Udhezimit nr. 12 dt. 30.06.2023, kandidatët shpallur fitues në bazë të rezultateve dhe kuotave të parashikuara, duhet të kryejnë regjistrimin (i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore sipas afatit të përcaktuar në kalendar, **në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit**) nga data **06 deri me datë 10 Tetor 2025**, duke dorëzuar pranë Sekretarive Mësimore përkatëse dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

6.1 Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në UKZKM (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

Emrin, atësinë, mbiemrin;

datëlindjen;

vendlindjen;

shtetësinë;

numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;

emrin e institucionit të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë/IAL-së ku ka kryer stu dimet

përpara ndjekjes së këtij programi studimi;

ID-në e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë1;

numrin personal të identitetit;

datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;

emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;

ciklin dhe formën e studimit;

datën e ndërprerjes së studimeve.

¹ Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e testimit duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.



6.2 Mandatin e kryerjes së pagesës së kështit të parë apo të kështit të plotë të tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studenti portal.unizkm.al, zëri “Tariffe”);

6.3 dy fotografi personale;

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:
- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studenti: portal.unizkm.al);
- Kontrata e regjistrimit.
- Formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 3, pjesë përbërëse udhëzimi;
- Deklaratën sipas shtojcës nr. 1, udhëzimi;

Dokumentacioni duhet të jetë fotokopje e noterizuar. Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj duhet të jetë i pajisur edhe me vulë Apostile. Dokumentacioni i dorëzuar për regjistrimin përfundimtar duhet të jetë identik me versionin elektronik të përdorur në regjistrimin për konkurs.

Kandidatët që e kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë vendit të cilët do të kenë mangësi në dorëzimin e dokumentit do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të lejohen të futen në provimet e semestrit të parë. Regjistrimi me rezervë nënkupton se mosrespektimi i kushteve brenda afateve të parashikuara nga Udhëzimet e ministrisë mund të sjellë për pasojë mos pajisjen me statusin student, e rrjedhë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik. Kandidatët fitues me diplomë të huaj, në këto programe studimi, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, si të gjithë kandidatët e tjerë, por regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, pa pasur domosdoshmërisht në momentin e regjistrimit dokumentin e njohjes dhe njësimit të lëshuar nga QSHA.

Kreu II-Procedurat e transferimit për kandidatë shtetas të huaj

1. Si të aplikoni për transferimin e studimeve

Sipas Urdhrit të përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 të QSHA-RASH dhe Udhëzimit nr. 12 dt. 30.06.2023, kandidatët e interesuar mund të aplikojnë për transferim të studimeve në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë të UKZKM nga data 01 Shtator deri në datën 12 shtator 2025 duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- të kryejnë regjistrimin *online* në Portalin e Universitetit: <http://admissions.unizkm.al/#/>
- të përzgjedhin zërin: “**Trasferimento degli studi**”
- të plotësojnë procedurën duke ngarkuar online kopje elektronike në format PDF (të skanuara në format pdf/A) dokumentacionin e mëposhtëm për transferimin e studimeve:



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

1. Kërkesën për transferim (shkarkohet në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>)
2. Kërkesën për transferim drejtuar IAL (shkarkohet në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>)
3. Planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse. Studenti që transferon studimet nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, dorëzon të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin planin e plotë të programit të studimit përfshirë syllabuset përkatëse si dhe listën e notave me kreditet e fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer;
4. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;
5. Kopje të njësuar me origjinalin të Diplomës e Shkollës së Mesme;
6. Certifikatë e Diplomës së shkollës së mesme me të dhënat përkatëse (provimi me shkrim, provimi me gojë, kreditet, pikët shtesë), që përbëjnë vlerësimin e përgjithshëm të Maturës Shtetërore. Në mungesë të certifikatës, mund të bashkëlidhet një vërtetim i vulosur dhe nënshkruar nga shkolla e mesme me vlerësimin e përgjithshëm të Maturës Shtetërore dhe rezultatet e detajuara (provim me shkrim, provim me gojë, etj);
7. Dëftesat e të gjitha viteve të Shkollës së Mesme;
8. Kopje të dokumentit të identifikimit;
9. Kandidati duhet të dërgojë gjithashtu në kërkesën për transferim një kopje të akreditimit institucional të Universitetit të origjinës dhe një kopje të akreditimit të fundit të programit të studimit që është objekt i kërkesës për transferim, ose dokumentet dhe/ose referencat e marra nga burime të tjera publike (agjenci akreditimi, ministri dhe institucione varësie, etj).
10. Kryerjen e pagesës prej 50€ për aplikimin për transferim² si me poshtë:
 - Me transferte bankare në llogarinë³ me këto të dhëna:
Përfituesi: Zoja e Keshillit të Mirë (Universiteti Katolik)
Banka: Intesa San Paolo Bank
BIC/Swift: USALALTR
IBAN: AL60208112040000030694935302
 - me kartë krediti online në portalin e universitetit: <https://admissions.unizkm.al/#/auth/signin>;
 - pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30.

Shënim: Dokumentacioni duhet të përkthehet në gjuhën italiane ose në gjuhën angleze para se të ngarkohet në portal.

Pas ngarkimit të dokumentacionit të mësipërm, do të kryhen verifikimet përkatëse dhe llogaritja e notës mestare për çdo kandidat. Kandidati mund të verifikojë statusin e tij të aplikimit në profilin e tij online në portalin: <http://admissions.unizkm.al/>.

² Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifatat duhet të mbërrin në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.

³ Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e testimit duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.



2. Procedurat e transferimit në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit të të njëjtit cikël, për programet e studimit në Mjekësi, Odontoiatri dhe Proteza Dentare:

Kandidatët që kanë ngarkuar dokumentacionin e plotë/të rregullt në Portalin e pranimeve: <http://admissions.unizkm.al/> dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare sipas V.K.M nr.436, dt. 03/06/2020, e ndryshuar me VKM nr.46 të datës 27/01/2021 të Republikës së Shqipërisë, do të vlerësohen paraprakisht për studimet universitare të kryera më parë. Nëse gjatë këtij procesi verifikimi, kreditet e fituara në programin nga vjen rezultojnë të mjaftueshme për të transferuar të paktën 30 kredite në programin ku aplikon për transferim, kandidatët do të konsiderohen “Kandidatë që kualifikohen për procesin e transferimit” dhe **duhet të kryejnë testimin e pranimit** pranë UKZKM për kuotat e parashikuara për transferim në programet e studimit në datat e mëposhtme:

- Testimet e pranimit do të kryhen pranë UKZKM në Rr. “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri, në datat:

Programi i studimit	Data	Ora
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në <i>Mjekësi</i>	24/09/2025	10:00
Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në <i>Odontoiatri dhe Proteza Dentare</i>	24/09/2025	12:00

Vlerësimi i kandidatëve nga vendet e BE- së dhe jo-BE- së bëhet në bazë të kriterëve të mëposhtme:

1. Testim me shkrim në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë në Shkencat Natyrore (Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)	30 pikë
2. Testim mbi njohjen e gjuhës italiane	20 pikë
3. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Totali	80 pikë

Brenda datës 16 shtator 2024, kandidatët nga vendet jo-BE që konsiderohen të kualifikuar për procesin e transferimit dhe të cilët do të marrin pjesë në testimet e pranimit në programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë do të duhet të **pagojnë tarifën prej 100 euro⁴ për pjesëmarrjen në testimin e pranimit** (pagesa do të kryhet me të njëjtat mënyra të përdorura për të paguar tarifën e transferimit 50 Euro).

Shënim: Pranohen pa kryer konkursin e pranimit dhe kanë përparësi në listën e renditjes së aplikantëve duke u renditur sipas kriterit të mesatares së ponderuar të provimeve të dhëna në Universitetin e origjinës, kandidatët që vijnë nga programe të njëjta studimi nga Universitete të Bashkimit Evropian, të njohura nga Universiteti ynë.

3. Procedurat e transferimit në programet e studimit në Arkitekturë, Ekonomi Ndërmarrjeje dhe Farmaci:

⁴ Komisionet paguhen nga dërguesi. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit, përndryshe regjistrimi është i pavlefshëm.



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Dokumentacioni i kandidatëve që paraqesin kërkesë transferimi për këto programe studimi do i përcillet Komisionit Didaktik *ad hoc* për vlerësimin e studimeve universitare të kryera më parë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara nga mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme dhe studimeve universitare të kryera më parë:

1.	Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	50 pikë
2.	Studimet universitare të kryera më parë (Kredite të njohura)	50 pikë
	Totali	100 pikë

Shënim: Kandidatët që nuk kanë të paktën 30 kredite të njohura në programin ku aplikojnë për transferim, aplikojnë për regjistrim në vit të parë. Komisioni Didaktik *ad hoc* përcakton lëndën dhe masën e njohjes së tyre,

4. Listat e renditjes

Listat e renditjes së aplikantëve do të publikohen në faqen zyrtare të UKZKM: <https://www.unizkm.al/> brenda dt. 26 shtator 2025. Kandidatët mund të përjashtohen nga lista e renditjes nëse gjenden parregullsi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim.

5. Procesi i regjistrimit

Sipas Urdhrit të përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 të QSHA-RASH dhe Udhezimit nr. 12 dt. 30.06.2023, kandidatët shpallur fitues në bazë të rezultateve dhe kuotave të parashikuara, duhet të kryejnë regjistrimin (i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore sipas afatit të përcaktuar në kalendar, **në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit**) nga data **06 deri me datë 11 Tetor 2025**, duke dorëzuar pranë Sekretarive Mësimore përkatëse dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

5.1 Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në UKZKM (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

Emrin, atësinë, mbiemrin;

datëlindjen;

vendlindjen;

shtetësinë;

numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;

emrin e institucionit të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë/IAL-së ku ka kryer studim përpara ndjekjes së këtij programi studimi;

ID-në e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë1;

numrin personal të identitetit;

datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;

emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

ciklin dhe formën e studimit;
datën e ndërprerjes së studimeve.

5.2 Mandatin e kryerjes së pagesës së kështit të parë apo të kështit të plotë të tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studenti portal.unizkm.al, zëri "Tariffe");

5.3 dy fotografi personale;

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studenti: portal.unizkm.al);
- Kontrata e regjistrimit.
- Formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 3, pjesë përbërëse udhëzimi;
- Deklaratën sipas shtojcës nr. 1, udhëzimi;

Dokumentacioni duhet të jetë fotokopje e noterizuar. Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një Universitet i huaj duhet të jetë i pajisur edhe me vulë Apostile. Dokumentacioni i dorëzuar për regjistrimin përfundimtar duhet të jetë identik me versionin elektronik të përdorur në regjistrimin për konkurs.

Kandidatët të cilët nuk janë në përputhje me dorëzimin e dokumenteve të lartpërmendura do të regjistrohen me rezervë dhe nuk do të mund t'i nënshtrohen provimeve derisa të disponohet dokumentacioni i kërkuar. Regjistrimi me rezervë do të thotë se mospërmbushja e kërkesave brenda afateve të përcaktuara me dekretet ministrore mund të rezultojë në mosmarrjen e statusit të studentit dhe për rrjedhojë humbjen e çdo të drejte ndaj Universitetit Katolik. Kandidatët e suksesshëm do të regjistrohen në vitin e parë të kursit me rezerva derisa të marrin numrin matrikullimit nga QSHA.

Shënim: Ju kujtojmë se shtetasit e huaj mund të qëndrojnë lirisht në Shqipëri për një periudhë maksimale prej 90 ditësh në një gjashtëmujor (gjashtëmujori llogaritet nga dita e hyrjes së parë në vend dhe 90 ditët llogariten duke shtuar të gjitha periudhat e qëndrimit në Shqipëri, edhe nëse jo të njëpasnjëshme). Ata që synojnë të qëndrojnë në territorin shqiptar për më shumë se 90 ditë në një gjashtëmujor, duhet të paraqesin kërkesë për leje qëndrimi pranë autoriteteve kompetente shqiptare dhe duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore një kopje të noterizuar të lejes së qëndrimit në Shqipëri.



Rrektori

Prof. Leonardo Palombi